



REPUBLIKA E KOSOVËS


REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E SHTIMES

MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE



ZYRA PËR INFORMIM/ INFORMATION OFFICE/ KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

Raporti i Diskutimit Publik për Programin Strategjik të Ujërave në Komunën e Shtimes

Organizata Sundimi i Demokracisë në Kosovë - SDK ka aplikuar në thirrjen e hapur nga IËRM-K me idenë që të ndihmoj nivelin lokal në hartim të politikave për mbrojtjen e ujrave, duke përpiluar një Strategji dhe Plan Veprimi konkret. Paraprakisht për këtë ka marrë një deklaratë mbështetëse nga Komuna e Shtimes për të zhvilluar këtë projekt në mirëkuptim dhe bashkëpunim me Komunën e Shtimes.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-147 për ujrat e Kosovës, gjegjësisht në nenet 40, 46, 47, 49, 51, 55, 57, 68 dhe 72 të cilat obligojnë nivelin lokal që të ndërmarrin masa në mbrojtje të ujrave, SDK i adresohet Kryetarit të Komunës së Shtimes që në bazë të procedurave ligjore të inicoj grupin punues për hartimin e politikave në ruajtje dhe mbrojtje të ujrave.

Komuna e Shtimes mirëkupton qëllimin e Projektit në fjalë, dhe shprehë vullnetin e mirë dhe gatishmërinë për të bashkëpunuar me Organizatën SDK në përmbushjen e qëllimit të projektit. Në këtë kontekst Kryetari i Komunës së Shtimes me datën 05.07.2023 merr vendimin për themelimin e Grupit Punues duke përfshirë sektorin e mjedisit dhe njëkohësisht përfshirjen e shoqërisë civile dhe përfaqësues lokal të autoriteteve për menaxhim të ujrave.

SDK, duke qenë implementuese e projektit ka ofruar ndihmë teknike për komunën e Shtimes në hartim të politikave në ruajtje dhe mbrojtje të ujrave, duke angazhuar ekspert që të ndihmoj komunën e Shtimes në identifikimin e nevojave dhe hapave që duhet të ndërmerrën për zhvillimin e Programit Strategjik për Ujrat dhe Planit të Veprimit. Poashtu ka organizuar 4 punëtori/tryeza diskutimi, me Grupin Punues, në mënyrë që të mbledhën të dhëna sa më shumë, nga akter të ndryshëm që ndërlidhën me fushën e mbrojtjes së ujrave. Duke qenë në këtë dinamikë të punimeve me Grupin Punues, SDK ka hartuar Draft Programin Strategjik për Ujrat në Komunën e Shtimes. Në mbledhjen e Kuvendit Komunal të Shtimes së datës 27.12.2023 ky dokument është nxjerrë në diskutim publik dhe që nga data 09.01.2024 është publikuar njoftimi për diskutim publik në ueb faqe të komunës.

Diskutimi publik është mbajtur me datën 23.01.2024 nga ora 14:00 në sallën e Kuvendit Komunal. Në këtë takim ishin prezent rreth 15 qytetarë të Komunës së Shtimes. Fillimisht është prezantuar më në detaje Draft Programi Strategjik për Ujrat me qëllim të informimit të qytetarëve si dhe njëkohësisht për të marrë parasyshë edhe komentet/sugjerimet e tyre lidhur me këtë dokument.

Më posht po paraqesim në formë tabelare komentet/sugjerimet e qytetarëve dhe adresimin e tyre.

Nr.	Kërkesat/Sugjerimet/Komentet	Kush ka dhënë kërkesë/sugjerim	Statusi i kërkesës/sugjerimi i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
1.	Programi Strategjik do duhej të ketë edhe kornizën buxhetore	Basri Hyseni	Pjesërisht e pranuar	Programi për ujrat është një dokument orientues strategjik. Logjika e këtij program ka për qëllim përcaktimin e masave dhe veprimeve për mbrojtjen e ujrave dhe identifikimin e burimeve të financimit. Pastaj komuna planifikimet buxhetore siç është KAB-i i rendit sipas orientimeve strategjike.
2.	Është Sfidë për Komunën e Shtimes se nuk ka një lokacion për hudhjen e mbeturinave		Aprovuar	Është e përfshirë në

	inerete dhe shumë qytetarë i hudhin përreth lumit. Çështje tjeter është edhe marrja në shfrytëzim e burimeve ujore (Krojeve) nga persona jo kompetent të cilët nuk kanë asnjë dokumentacion që i'u njeh të drejten e shfrytëzimit të një resursi ujor, e që në këtë rast ndikon në një rrjedhë lumore. Këto janë disa problematika që do të duhej të trajtohen.	Albulenë Emini	Pjesërisht e pranuar	kuadër të Masës 2.1.1 Është e përfshirë në kuadër të Masës 1.1.3
3.	Në komunën e Shtimes ka ende ekonomi familjare që nuk paguajnë mbeturinat dhe sipasoj e saj ndotet lumi nga mbeturinat. Do duhej që të ndërmerren masa në këtë drejtim	Xhevat Tërshana	Aprovuar	Është e përfshirë në kuadër të Masës 2.1.1
4.	Te gjitha ujrat e zeza derdhen në lum Shtrati i lumit në vazhdimësi ngushtohet nga mbjellja e shelnjeve në pronat private. Faktori njeri është shkaktari kryesor pse ndodhin vërshimet, për arsye se po degradohen lumenjtë. Do duhej të merren masa për vetëdijesimin qytetarë. Kjo do duhej të ndodh që nga edukimi i hershëm, në mënyrë që të vetëdijësohemi si shoqëri.	Behadin Rexhepi	Aprovuar Aprovuar Aprovuar	Është e përfshirë në kuadër të Masës 1.1.4 dhe 1.2.2 Është e përfshirë në kuadër të Masës 2.1.3 Është e përfshirë në kuadër të Objektivës 4 dhe Masës 4.1.1